

Dt. 05.03.2021

VENDIM
“NE EMER TE REPUBLIKES”
Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane
Gjyqtar Altin Abdiu

asistuar nga sekretar gjyqesor **Rei Peçi**, me date 05.03.2021, perfundoi se shqyrtuari ne seance gjyqesore publike ceshtjen penale qe u perket;

Prokuroria Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, perfaqesuar nga prokurori **Ervin Karanxha**, jo prezent ne shpalljen e vendimit.

I pandhur: **Andon Pango**, i biri i Ndreko dhe i Stamato, i dtl. 29.09.1966, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, Rruga “Thanas Ziko”, nr.6/2, shtetesi e kombesi shqiptare, arsimi i larte, inxhinier, i martuar, pa mase sigurimi, i padenuar, identifikuar me karte identiteti me nr. personal G60929056O, ne mungese, i perfaqesuar me prokure te posaqme nga av. Gazmend Zeneli, Dhoma e Avokatisse Tirane, jo prezent ne shpalljen e vendimit.

Akuzuar: Per kryerjen e vepres penale “Mashtrimi” me pasoja te renda, parashikuar nga neni 143 pg. 3 i K.Penal.

Viktima: **Alush Alla**, i biri i Beshir dhe i Bejte, i dtl.07.04.1953, lindur dhe banues ne Tirane, Prane kopshti zoologjik, Rruga “Haxhi Brari”, pll. “Fleg”, nr. 12, shtetesi e kombesi shqiptare, arsimi i mesem, pensionist, i martuar, i padenuar, identifikuar me karte identiteti me nr. personal F30407094M, mbrojtur me deklarim nga av. Hysni Beti, Dhoma e Avokatisse Tirane.

Ne konkluzionet perfundimtare prokurori kerkoj:

- Deklarimin fajtor te pandehurit Andon Pango per kryerjen e vepres penale “Mashtrimi”, me pasoja te renda, bazuar ne nenin 143 pg.3 te K.Penal, denimin e tij me 5 vjet burgim. Aplikimin e kerkesave te nenit 59 te K.Penal, pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim dhe venien ne prove te pandehurit per nje afat dy vjeçar.
 - Bazuar ne nenin 60/3 te K.Penal, duhet te detyrohet i pandehuri te rikuperoje demin civil te shkaktuar viktimes, gjate kohe se proves duhet ti jape leket ose ti riktheje apartamentin, ne rast te kundert ti hiqet pezullimi i ekzekutimit te denimit me burgim.
 - Shpenzimet e hetimeve paraprake ne shumen 1000 leke dhe ato gjyqesore ti ngarkohen te pandehurit.
 - Perfaqesuesi i te pandehurit kerkoj deklarimin e pafajshem te te pandehurit Andon Pango, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veper penale.
 - I pandehuri ne mungese.
 - Avokati i viktimes kerkoj deklarimin fajtor te pandehurit Andon Pango per kryerjen e vepres penale vjedhja me ane te mashtrimit, me pasoja te renda, bazuar ne nenin 143/3 te K.Penal, denimin e tij me 10 vjet burgim. Mospranimin e kerkeses se prokurorit per pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim.
 - Viktima ishte dakort me avokatin.
- Gjykata pasi shqyrtoi 5eshtjen ne teresi,

VEREN

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane me vendimin nr. 1133 Regj. Themetar date 26.04.2019 ka vendosur dergimin ne gjyq te çeshtjes penale ne ngarkim te te pandehurit Andon Pango i akuzuar per kryerjen e vepres penale "Mashtrimi" me pasoja te renda, parashikuar nga neni 143 pg. 3 i K.Penal.

Ne fazen e kerkesave paraprake nga viktimja e vepres penale Alush Alla, u paraqit kerkesa per shqyrtimin e padise civile ne procesin penal, ndaj te paditurit (te pandehurit) Andon Pango me objekt: Konstatimin e pavlefshmerise absolute te kontrates se shitblerjes se pasurise me nr. 1107 rep 364 kol. date 21.05.2018 te noteres Alma Hoshi, lidhur midis te paditurve civil Shoqeria "Fleg" shpk me administrator Andon Pango dhe Naim Çupi si bleser. Detyrimin e te paditurit Andon Pango per te paguar demin financiar dhe fitimin e munguar. Sigurimin e padise me ane te venies se sekuestros mbi pasurine e shoqerise "Fleg".

Gjykata pasi degjoi prokurorin, i cili e la vleresimin e kesaj kerkese ne çmim te Gjykates, perfaqesuesin e te pandehurit, i cili kerkoi mospranimin per shqyrtim te padise civile ne kete proces penal, bazuar ne nenin 62 te K.Pr.Penale, per shkakun se gjykimi i kesaj padie do te veshtiresonte dhe zvarriste procesin penal, ne seancen gjyqesore te dates 28.10.2019, ka vendosur, veçimin e padise civile nga ky proces penal, dergimin e padise civile ne Dhomen Civile te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane.

Nga hetimi gjyqësor i çeshtjes, e cila eshte ne juridiksionin dhe kompetencen e kesaj Gjykate, ka rezultuar se :

Rrethanat e faktit penal.

Ne date 06.07.2018 shtetasi Alush Alla ka bere kallezim penal ne Prokurorine e Rrethit Gjyqësor Tirane ne ngarkim te shtetasit Andon Pango me detyre administrator i personit Juridik Shoqeria "Fleg" Sh.p.k. me Administrator dhe ortak te vetem ne cilesine e investitorit/sipermarres me nr.NIPT: J8230400 1M, per kryerjen e vepres penale "Mashtrimi" parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal. Gjithashtu, eshte bere kallzim penal ne ngarkim te drejtuesve dhe specialisteve te Drejtorise se ALUIZNI-t Tirana Rurale, Drejtorit te saj Krenar Canollari, per kryerjen e vepres penale te "Shperdorimit te detyres", ne bashkepunim, te parashikuar nga neni 248-25 te Kodit Penal, per shkak te leshimit te lejes se legalizimit ne favor te shoqerise "FLEG" sh.p.k. me lejen e legalizimit Nr.7004042 dt.11.08.2017 ne kundertshtim me ligjin Nr. 9482 date 03.04.2006 "Per Legalizimin, Urbanizimin Integrimin e Ndertimeve pa Leje" te ndryshuar dhe akteve te tjera nenligjore duke u leshuar leja e legalizimit e sipercituar ne kundertshtim me Ligjin ne nje kohe qe Shoqeria "FLEG" sh. p.k., per ndertimin e kesaj godine eshte pajisur me lejen e ndertimit Nr. 1 date 12.04.2006 dhe Vendimin e K.RR.T. Nr. 12 dt.08.12.2005 te Komunes Farke Tirane dhe ne ngarkim te specialisteve te Zyres Vendore te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Tirane, per vepren penale te "Shperdorimit te detyres" parashikuar nga neni 248 e 25 te Kodit Penal.

Ne date 29.01.2007, shtetasi Alush Alla sipas kontrates Nr. 169 Rep. dhe Kol 53, nga shoqeria ndertuese "Fleg" Sh.p.k me pronar shtetasin Anton Ndreko Pango, ka blere nje apartament ne katin e peste te ketij pallati me siperfaqe 255 m2 dhe me çmim 135.000 euro. Ky pallat ndodhet ne Tirane prane kopshtit zoologjik. Ne momentin qe ka blere kete apartament, pallati ishte ndertuar nga kjo firme vetem ne karabina. Shtetasi Alush Alla deklaroi se pas kontrates dhe kalimit te shumes se lekeve nga ana e tij nepermjet bankes me marreveshje me shtetasin Andon Pango ka bere vete ndarjen e apartamentit.

Gjithashtu, sipas kontrates se porosise nr. 168 rep. dhe kol 52 date 29.01.2007, lidhur mes Alush Alla dhe sipermarresit, Shoqeria "Fleg" Sh.p.k, me administrator dhe ortak te vetem Andon Ndreko Pango, viktimja ka blere dhe nje njesi dyqan me siperfaqe 223 m2 tek kjo firme ne nje pallat ngjitur me pallatin e pare ne shumen prej 330.000 euro. Me pas ai ka pare se ne ballkonin e apartamentit qe kishte blere nga firma ndertuese "Fleg", kjo firme kishte ndertuar nje oxhak per pallatin, i cili nuk ishte ne projektin e pallatit. Pas kesaj ai ishte

interesuar per projektin e pallatit ne Komunen "Farke" dhe kishte mesuar se nuk kishte oxhak ne lejen e ndertimit te pallatit. I ndodhur ne keto rrethana Alush Alla ka prishur oxhakun, i cili ishte ne ballkonin e apartamentit te tij.

Ne lidhje me blerjen e objekteve te permendura me lart, me shoqerine ndertuese "Fleg", shtetasi Alush Alla ka bere disa here gjyqe civile pasi kjo shoqeri nuk i ka dorezuar dyqanet me certifikate pronesie sipas kontratave te shitjes. Per apartamentin dhe per dyqanet jane zhvilluar te gjitha shkallet e gjykimit ku ka fituar shtetasi Alush Alla, por viktimat akoma nuk disponon certifikate pronesie per objektin qe ka blere, pasi shtetasi Andon Pango nuk ka regjistruar pronat ne emer te shoqerise "Fleg" si ndertues, por i ka regjistruar ato ne emrin e vete Andon Pango, si person fizik. Shtetasi Alush Alla ka deklaruar se, i pandehuri Andon Pango megjithese kishte marre leje ndertimi per ndertimin e pallatit ne fjale, ai ka bere kerkese prane ALUIZNI dega Tirane per te legalizuar pallatin me pretendimin se, gjate ndertimit te pallatit ishin bere shtesa me ndertim pa leje. Pasi ka marre lejen e legalizimit ai ka bere kerkese per regjistrimin e pallatit ne ZVRPP Tirane, por shtetasi Alush Alla nuk i ka dhene asnje certifikate pronesie per objektet qe ai kishte blere tek kjo firme nga shtetasi Andon Pango. Ky pallat ka aktualisht 6 kate dhe eshte i lyer me ngjyre si portokalli e hapur. Sipas kontrates se porosise me nr. 169 Rep dhe 53 kol date 29.01.2007, viktimat Alush Alla i ka dhene te pandehurit Andon Pango shumen prej 120 000 euro dhe ai brenda 18 muajve do t'i dorezonte hyrjen ne fjale. Kjo hyrje ndodhet ne katin e fundit te ketij pallati.

Si ne kallezimin e paraqitur dhe ne gjykim, viktimat Alush Alla deshmoi se, kontrata nuk eshte realizuar pasi shtetasi Andon Pango e ka mashtruar dhe megjithese ai i ka marre shumen e lekeve, nuk i ka dorezuar hyrjen qe kishte blere. Viktimat Alush Alla deshmoi se, apartamentin per te cilin kishte paguar shumen prej 120 000 euro, i pandehuri Andon Pango me pas ja ka shitur nje personi tjeter, shtetasi Naim Çupi dhe nuk i ka kthyer asnje leke atij.

Si ne hetimet paraprake, nga i pandehuri dhe gjate gjykimit nga perfaqesuesi i tij me prokure, eshte pretenduar se ne vitin 2006, shtetasi Andon Pango ne cilesine e administratorit te firmes "Fleg" shpk, ka ndertuar nje pallat ne vendin e quajtur prane "Kopshtit Zoologjik" Tirane. Ne kete kohe ai eshte njohur me shtetasin Alush Alla, i cili kishte disa leke gjendje dhe donte te investonte. Ata kane bere marrveshje me Alushin qe ai te blinte disa ambiente me çmim te arsyeshem dhe pikerisht nje apartament dhe tre dyqane. Te gjitha keto me nje çmim prej 470 000 euro. Kjo shume sipas kontratave qe kane lidhur duhej te likuidohej deri ne muajin maj te vitit 2007. Gjate kesaj periudhe ai deklaroi se kishin mosmarrveshje me shtetasin Alush Alla, derisa çeshtja kishte shkuar ne prokurori. Nga kjo ai deklaroi se eshte detyruar te bente zgjidhjen e kontrates ne menyre te njeanshme per te vazhduar punimet. Gjate kesaj periudhe shtetasi Alush Alla kishte hapur disa çeshtje civile, ku ky i fundit kishte bere ankime ne lidhje me vendimet e gjykatave. Perfaqesuesi i te pandehurit, pretendon se shtetasi Alush Alla, sipas kontrates qe kishte bere me te do te paguante deri ne muajin maj te vitit 2007, shumen prej 135 mije euro per nje apartament ne katin e gjashte te pallatit ku po ndertonte firma "Fleg". Alush Alla jo vetem qe nuk ka paguar keto leke, por ka sjelle probleme per mbarevajtjen e punes si dhe ka zaptuar nje pjese prej 120 m2 truall te ketij pallati. Trualli eshte i firmes "Fleg" mbi te cilin eshte ndertuar pallati. Shtetasi Alush Alla ne truallin qe ka zaptuar pretendon qe te ndertoje nje pallat. Ky truall eshte i ngjitur me pallatin dhe eshte pjese e pallatit. Gjithashtu ky shtetas ka zaptuar dhe nje pjese verande me siperfaqe 102 m2, ne pronesine e shtetasve Andon Pango dhe Shefikat Ngjela. Perfaqesuesi i te pandehurit pretendon se keto dy siperfaqe i konsideron te pushtuara dhe duke qene se ka detyrime ndaj Alushit me nje vlere prej rreth 60 mije euro, ka menduar te beje vleresimin e truallit dhe te verandes dhe t'ia kaloje shtetasit Alush Alla dhe te shlyeje detyrimin qe ka ndaj atij. Ai deklaroi se shtetasi Alush Alla per apartamentin me siperfaqe 255m2 se bashku me veranden dhe ambientet e perbashketa, ka paguar rreth 70 mije euro. Ndersa per dyqanet ai ka paguar rreth 330 mije euro dhe keto objekte ai nuk i ka kaluar ne pronesine e tij sipas kontratave te

shitjes, pasi Alushi nuk ka paguar te gjitha leket ne kohen e duhur duke i sjelle probleme me mbarevajtjen e firmes, duke mos paguar leket ne kohen e duhur, ka sjelle probleme teknike duke i uzurpuar pjesen e truallit dhe i ka sjelle probleme morale duke e sjelle ne Prokurori dhe Gjykata. Ai deklaroi se eshte dakort qe t'i ktheje 65 mije euro shtetasit Alush Alla dhe ai t'i liroje pjesen e truallit dhe pjesen e verandes qe ka zene. Persa i perket apartamentit qe ka blere tek kjo firme nuk ja kalon ne pronesine e tij pasi e ka tjetersuar qe ne vitin 2008 - 2009 duke ja shitur shtetasit Naim Çupi dhe ai ka bere investime kolosale, te cilat jane te pakthyeshme. Ai deklaroi se nuk i ka kthyer asnje leke ne lidhje me kete apartament. Perfaqesuesi i te pandehurit shpjegoi se, kontraten e shitjes me shtetasin Naim Çupi e ka perpiluar tek noterja Alma Poshi ne vitin 2009, duke paraqitur si dokumenta lejen e ndertimit te pallatit si dhe dokumentin e prishjes ne menyre te njeanshme te kontrates se porosise mes shtetasit Alush Alla dhe firmes "Fleg". Perfaqesuesi i te pandehurit deklaroi se pallati ku eshte apartamenti, eshte 5 kate me kupole dhe me nje kat parkim nen toke. Per legalizimin e ketij pallati eshte paraqitur dokumentacioni, nje pjese shtese qe ka ndertuar mbi pallat e cila nuk eshte konsideruar nga hipoteka si kat me arsyen se jane shkalle te pallatit te cilat nuk hipotekohen. Keshtu qe pallati ngelet sipas lejes se ndertimit 3 dhe 5 kate me kupole dhe nje kat parkim nen toke, pra me 6 kate dhe eshte regjistruar ne ZVRPP Tirane me 6 kate dhe nje kat nen toke.

Ne gjykim avokati i viktimes i qendroi faktit penal te paraqitur ne kallezimin e shtetasit Alush Alla.

Ne konkluzionet perfundimtare avokati i viktimes kerkoi deklarimin fajtor te te pandehurit per kryerjen e vepres penale vjedhja me ane te mashtrimit, me pasoja te renda, bazuar ne nenin 143/3 te K.Penal, denimin e tij me 10 (dhjete) vjet burgim. Gjithashtu u kerkua qe te mos pranohet kerkesa e prokurorit per pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim, pasi nje kerkese e tille ka rezultuar e pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Ekzistenca e faktit penal u vertetua me keto prova te marra dhe te verifikuara ne hetimin gjyqesor:

-Deshmia e deshmitarit **Krenar Cenollari**, i cili konfirmoi ne seance gjyqesore deklarimet e dhena ne hetime paraprake, se nga muaji qershor i vitit 2017 e deri ne muajin Korrik te vitit 2018 ka punuar ne detyren e Drejtorit te ALUIZNI Tirana Rurale. Ne lidhje me vetedeklarimin me nr. 54 prot date 31.05.2017 me vetedeklarues Andon Ndreko Pango per shoqerine "Fleg" Sh.p.k., ne date 31.05.2017 shtetasi Andon Ndreko Pango administrator i shoqerise "Fleg" Sh.p.k, ka bere vetedeklarimin e mesipem ku ka kerkuar perfshirjen dhe legalizimin e nje objekti pallat shtate katesh plus nje kat nen toke me adrese Njesia Administrative Farke. Praktika e sipercituar eshte trajtuar konform ligjit nr. 9482 date 03.04.2006 "Per legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndertimeve pa Leje" i ndryshuar ne favor te firmes "Fleg" Sh.p.k. Eshte emetuar leja e legalizimit nr.7004042 date 11.08.2017. Gjate shqyrtimit te praktikës se sipercituar jane konstatuar shkelje mbi projektin e miratuar pasi objekti kishte nje leje ndertimi. Pas verifikimeve te grupeve te terrenit fizikisht te objektit ka rezultuar se ky objekt kishte ndryshime ne projekt dhe pikerisht kishte shtesa ne vellimin e ndertimit. Pikerisht jane evidentuar shtesat ne ndertimin e objektit, pra subjekti ndertues kishte dale nga leja e ndertimit. Praktika e legalizimit ka dale me urdher pune. Me tej zyra e hartografise ka vazhduar me perpunimin e materialeve tekniko ligjore me vetedeklaruesin ne proces legalizimi ku jane pare dhe jane verejtur se te gjithë dokumentacionet tekniko ligjore kane qene konform ligjit. Me tej praktika ka kaluar ne sektorin e kompesimit dhe te çeshtjeve te pronesise. Perputhja e parceles ndertimore me objektin ne fjale eshte bere referuar hart karteles se pronesise me volum 14 faqe 58 ZK 3292 dhe dosja ka kaluar nga sektori i çeshtjeve te pronesise ne sektorin e çeshtjeve te legalizimeve ku eshte bere dhe legalizimi sipas V.K.M nr. 280 date 01.04.2015 "Per percaktimin e kriterëve e procedurave dhe dokumentacionit te zbatueshem "Per te kualifikuar ndertimet pa

leje shtese anesore ose ne lartesi ne ndertime me leje i ndryshuar". Vendimi per kualifikim eshte marre nga zyra e legalizimit dhe eshte emertuar leja me legalizimin me nr. 7004042 date 11.08.2017 pasi jane konfirmuar te gjitha procedurat qe jane konform ligjit ne fuqi. Persa sa me siper praktika i eshte percjelle ZVPP Tirane me shkresen nr. 614 prot date 29.08.2017, per regjistrimin e kesaj pasurie konform parashikimeve te nenit 49 te ligjit nr. 33/2012 per regjistrimin e pasurive te paluajteshme i ndryshuar dhe V.K.M nr.1095 date 28.12.2015 "Per percaktimin e rregullave te bashkerendimit te punes nepermjet ALUIZNIT dhe ZVRPP Tirane" te procedurave apo kufizimeve qe zbatohen per efekte te regjistrimit te pasurive te palegalizuara. Shtetasi Krenar Canollari deklaroi se gjate kohes se ndjekjes se kesaj praktike ne Zyren e ALUIZNI Tirana Rurale, nuk ka patur asnje kerkese, apo ankese per pezullimin e kesaj praktike legalizimi nga asnje pale konform ligjit ne fuqi dhe e gjithes procedure e dhenies se lejes se legalizimit nr. 7004042 date 11.08. 2017 eshte ndjekur konform ligjeve ne fuqi per legalizimin e objekteve me lejen e ndertimit ose pa leje ndertimi. Pikerisht kjo leje legalizimi eshte leshuar ne zbatim te Ligjit nr. 9482 date 03.04.2006, i ndryshuar dhe ne zbatim te V.K.M nr. 280 date 01.04.2015 ku ne kete V.K.M percaktohen kushtet per legalizimin e objekteve te cilat kane leje ndertimi.

-Praktika e mesiperme per legalizimin e objektit eshte pohuar dhe me deshmite e ish punonjesve te ALUIZN-it Tirane Rurale, deshmitareve Klarend Hadaj, Mirel Lazaj, Marsela Veizaj.

-Sipas Aktit te ekspertimit teknik date 08.12.2018, eshte konkluduar se, Godina e banimit e ndertuar nga shoqeria e ndertimit "FLEG" sh.p.k me vend ndertimi Selite (kopshti botanik Tirane) eshte me 6 kate mbi toke dhe nje kat nentoke parkimi, me tarrace me dalje te shkalles me siperfaqe 34m2 mbi tarrace. Siperfaqja ndertimore e godines se ndertuar, realisht nuk perputhet me siperfaqet e vetedeklaruara per ALUIZNIN nga shoqeria "FLEG" sh.p.k. Kjo shoqeri ka kerkuar nepermjet vetedeklarimit siperfaqen e tarraces prej 289 m2 qe te legalizohet ne emer te kesaj shoqerie duke emeruar tarracen si kati i 7 i banimit. Siperfaqet faktike te ndertimit te kesaj godine banimi perputhen plotesisht me siperfaqet e ndertimit te miratuara nga Aluizni me vendimin nr.7004042 date 11.08.2017.

Persa me siper, sipas ketij Akti te ekspertimit teknik, rezulton se siperfaqja faktike e ndertimit te objektit te legalizuar perputhet plotesisht me siperfaqet e ndertimit te miratuara nga ALUIZNI Tirana Rurale, me vendimin nr.7004042 date 11.08.2017.

- Shkresa nr. 388021 prot. date 13.04.2018 e Zyres Qendrore te Pasurive Tirane;
- Procesverbali i kqyrjes date 04.10.2018 i opgj Shkelqim Tahiraj;
- Procesverbali i marrjes se dokumentave date 07.09.2018 i opgj Shkelqim Tahiraj;
- Procesverbali per marrjen e dokumentave date 23.03.2019 i prokurorit Ervin Karanxha nga shtetasi Arben Meskuti.
- Procesverbali per marrjen e dokumentave date 03.04.2019 per marrjen e dokumentave nga shtetasi Xhoni Bodo.
- Procesverbali per kqyrjen dhe marrjen e dokumentave date 06.03.2019 ku opgj ka marre nga shtetasi Alush Alla keto dokumenta:
- Kontrate porosie nr. 169 rep. dhe nr. 53 kol. date 29.01.2007 mes paleve shoqeria "Fleg" shpk dhe Alush Alla,
- Kontrate porosie nr. 168 rep dhe nr. 52 kol. date 29.01.2007.
- Vertetimi i dates 27.10.2020 i Gjykates se Apelit Tirane.
- Deklarate Noteriale nr.2691 rep. dhe nr. 791 kol. date 30.10.2019 se bashku me karten e identitetit te viktimes Alush Alla.
- Deklarata Noteriale nr.2748 rep. dhe nr. 768/1 kol. date 01.11.2019.

Ne perfundim te hetimeve, prokurori ka konkluduar se nga ana e punonjesve te ALUIZNI-t Tirana Rurale gjate legalizimit te ketij objekti nuk eshte kryer ndonje veper penale.

Ndersa persa i perket te pandehurit Andon Pango, eshte konkluduar se nepermjet veprimeve te kundraligjshme te kryera, duke shitur dy here te njejtin apartament, per te cilin fillimisht kishte lidhur nje kontrate porosie me viktimen Alush Alla dhe kishte marre prej tij shumen 120 000 (njqind e njezete mije) euro, pa i kthyer kete shume viktimes, e ka shitur tek shtetasi Naim Çupi, i pandehuri ka konsumuar elementet e vepres penale "Mashtrimi" me pasoja te renda, parashikuar nga neni 143 pg.3 te Kodit Penal.

Ligji i zbatueshem dhe vleresimi i Gjykates.

Ne nenin 143 te K.Penal, me titull "Mashtrimi", eshte parashikuar se :

"-Pervetesimi i pasurise private ose publike nepermjet paraqitjes se fakteve te rreme ose duke fshehur fakte te verteta, genjeshtres ose shperdorimit te besimit, per vete ose persona te tjere, perben vepren penale te mashtrimit dhe denohet me burgim deri ne pese vjet.

-Kjo veper, kur kryhet ne bashkepunim ose me shume se nje here, denohet me burgim nga dy deri ne gjashte vjet.

-Kur vepra, ka sjelle pasoja te renda denohet me burgim nga pese deri ne dhjete vjet. "

Ne keto kushte, bazuar ne provat e mesiperme te marra dhe te verifikuara ne hetimin gjyqesor, Gjykata e gjen te drejte akuzen e ngritur nga prokuroria, sepse, krijon bindjen tej çdo dyshimi te arsyeshem se i pandehuri Andon Pango me veprimet e kundraligjshme te kryera, ka konsumuar plotesisht elementet e figures se vepres penale "Mashtrimi" me pasoja te renda, parashikuar nga neni 143 pg.3 i K.Penal.

- Objekt i kesaj vepre penale, jane marredheniet juridike te vendosura me ligj per te siguruar te drejtat pasurore te individit, te mbrojtura posaçerisht me legjislacionin penal, nga veprimet ose mosveprimet kriminale.
- Nga ana objektive, vepra penale eshte kryer nepermjet veprimeve te kundraligjshme te te pandehurit, i cili ndonese ka lidhur kontraten e porosise nr. 169 rep. dhe nr. 53 kol. date 29.01.2007, me viktimen Alush Alla dhe sipas kesaj kontrate ka marre shumen 120 000 (njqind e njezete mije) euro, nuk e ka realizuar kete kontrate dhe nepermjet genjeshtres dhe shperdorimit te besimit, kete apartament ja ka shitur shtetasit Naim Çupi, por nuk i ka kthyer viktimes Alush Alla shumen e marre.
- I pandehuri eshte subjekt i vepres penale sepse, ka mbushur moshen per pergjegjesi penale dhe eshte i pergjegjeshem perpara ligjit per vepren e kryer.
- Nga ana subjektive, vepra penale eshte kryer me dashje direkte me qellim perfitimi material.

Vepra penale me te drejte eshte cilesuar me pasoja te renda sipas paragrafit te trete te nenit 143 te K.Penal, sepse, ne Vendimin Unifikues Nr. 5 date 11.11.2003 te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, eshte theksuar se kur vlera e vjedhur individeve eshte mbi 1 000 000 (nje milion) leke, vepra penale duhet cilesuar me pasoja te renda.

Nga sa u arsyetua me sipër, Gjykata i gjen te pabazuara ne ligj pretendimet e perfaqesuesit te te pandehurit per deklarimin e tij te pafajshem, pasi ne rastin konkret fakti penal nuk ekziston dhe se kemi te bejme me nje marrdhenie juridiko-civile. Rezultoi e provuar se mosmarreshjet juridiko-civile te pretenduara nga i pandehuri per te cilat jane zhvilluar disa procese gjyqesore civile, jane perdorur prej tij si mjet per t'ju shmangur kthimit te shumes qe i ka marre viktimes dhe pergjegjesise penale.

Ne caktimin e llojit dhe te mases se denimit Gjykata ka parasysh :

Rezrikshmerine e larte shoqerore te vepres penale, e cila eshte e perhapur ne shoqeri.

Rezrikshmerine relativisht te larte shoqerore te te pandehurit per te cilin rezulton se, nuk i eshte caktuar mase sigurimi, eshte i padenuar, mban qendrim mohues per vepren e kryer.

Ne keto kushte, nisur nga rrezikshmeria shoqerore e vepres penale dhe e te pandehurit, shkalla e fajit, Gjykata çmon se ai duhet denuar me 6 (gjashte) vjet burgim per kryerjen e vepres penale "Mashtrimi" me pasoja te renda, parashikuar nga neni 143 pgr. 3 i K.Penal.

Ky denim çmohet nga Gjykata se do te sherbeje per edukimin dhe rehabilitimin e te pandehurit si dhe per parandalimin e kesaj vepre ne shoqeri.

Per sa i perket kerkeses se prokurorit per pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim per te pandehurin.

Gjykata i referohet nenit 59 te K.Penal, me titull "Pezullimi i ekzekutimit te denimit me burgim dhe venia ne prove" ne te cilin nder te tjera eshte parashikuar se :

"Per shkak te rrezikshmerise se paket te personit, moshes, kushteve shendetesore.... dhe nevojave, veçanerisht atyre qe lidhen me familjen, shkollimin... si dhe te sjelljes pas kryerjes se vepres penale. Gjykata kur jep nje denim me burgim deri ne pese vjet, mund te urdheroje qe i denuari te mbaje kontakte me sherbimin e proves dhe te vihet ne prove, duke pezulluar ekzekutimin e denimit... "

Referuar permbajtjes se ketij neni, Gjykata çmon se nuk duhet pranuar kerkesa e prokurorit per pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim, per shkakun se ne rastin konkret nuk plotesohet ndonje nga kushtet e percaktuara ne paragrafin e pare te ketij neni per pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim.

Meqenese i pandehuri rezultoi fajtor per vepren qe akuzohet, ne zbatim te neneve 393.1 dhe 485 te K.Pr.Penale, ai duhet te ngarkohet me pagimin e shpenzimeve procedurale.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne zbatim dhe te neneve 379 - 384, 390 te K.Pr.Penale

VENDOSI

- Deklarimin fajtor të pandehurit **Andon Pango** për kryerjen e veprës penale "Mashtrimi" me pasoja te renda, bazuar ne nenin 143 pg.3 të K.Penal, denimin e tij me 6 (gjashte) vjet burgim.
- Vuajtja e denimit per te pandehurin **Andon Pango** te filloje nga dita e ekzekutimit te ketij vendimi.
- Shpenzimet e hetimeve paraprake dhe ato gjyqesore i ngarkohen te pandehurit.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditesh nga e nesermja e shpalljes ne Gjykatën e Apelit Tirane.
- U shpall në datë 05.03.2021.

SEKRETAGJYQTAR

REI PEÇIALTIN ABDIU

Shpenzimet gjyqesore
Hetimet paraprake te paevidentuara
12 (dymbedhjete) fletethirre 150 (njqind e pesedhjete) leke secila